



Mbështetja e reformave zgjedhore në Maqedoninë e Veriut

Sfondi

“Mbështetja e reformave zgjedhore në Maqedoninë e Veriut” është Projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), të cilin e implementon Fondacioni Ndërkombëtar për Sisteme Zgjedhore (IFES) dhe partneri i tij Këshilli Nacional Rinor i Maqedonisë (KNRM).

Projekti synon procese zgjedhore më gjithëpërfshirëse dhe më demokratike të drejtuara konform organizimit të përmirësuar të zgjedhjeve, të vëzhguara për së afërmi nga qytetarët. Është projektuar një qasje strategjike e trefishtë: 1. Të ndërtohen kapacitetet e administratës zgjedhore e cila do t'i administrojë zgjedhjet; 2. Të mbështeten më shumë politika dhe programe partiake me orientim qytetar përmes dialogut politik dhe hulumtime dhe politika të bazuara në prova; 3. Të inkurajohen qytetarët t'i thërrasin në përgjegjësi partitë dhe funksionarët e zgjedhur për premtimet e tyre.

Projekti korrespondon me prioritetet dhe rrjedhat e sapo shfaqura në arenën politike dhe zgjedhore, së këtejmi duke i mbështetur impenjimet e shtetit për integrimet euroatlantike.

Ndërhyrjet e propozuara kërkojnë vullnet dhe përkushtim politik të të gjithë protagonistëve relevantë - institucioneve, partive politike, shoqërisë civile dhe votuesve – në mënyrë që të përmirësohet sjellja dhe kapacitetet, si dhe të pëvetësohen parimet demokratike të pjesëmarrjes, përfshirjes, transparencës dhe llogaridhënies.

Qëllimi i përgjithshëm

Procese zgjedhore demokratike dhe të besueshme me të cilët lehtësohet pjesëmarrja politike dhe integrimi social në mënyrë që votuesit të kenë mundësi t'i zgjedhin përfaqësuesit e tyre dhe t'i thërrasin në përgjegjësi.

Rezultatet kryesore

Rezultati 1: Institucionet e fuqizuara zbatojnë procese zgjedhore të drejta dhe efikase.

Aktivitete kryesore për Rezultatin 1: Realizimi nga ana e administratës zgjedhore do të përforcohet përmes ndërtimit institucional dhe ndihmës së specifikuar për KSHZ1, dhe përmes përmirësimit të njohurive dhe aftësive të trupave zgjedhorë në nivelet më të ulët (KKZ dhe KZ)2. Këtu nënkuptohet edhe përfshirja e politikave të qëndrueshme, sistemeve dhe mekanizmave

1KSHZ – Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve

2KKZ – komisionet komunale të zgjedhjeve; KZ – këshillat zgjedhorë





(duke e përfshirë edhe softuerin dhe harduerin), dhe mbajtje llogari që funksionarët zgjedhor të pajisen me njohuri, kapacitete dhe resurse për kryerjen me sukses të detyrave të tyre.

Rezultati 2: Demokratizimi i brendshëm i partive politike përfaqëson politika dhe programe zgjedhore me orientim qytetar.

Aktivitete kryesore për Rezultatit 2: Partitë politike do t'i qasen demokratizimit të tyre të brendshëm, që do të rezultojë me politika dhe programe zgjedhore me orientim qytetar. Do të krijohet qasje e specifikuar që çdo parti politike t'i rris kapacitetet dhe resurset e veta (IAC3 dhe të rinjtë) që në mënyrë plotësuese ta avancojnë zbatimin e hulumtimeve të bazuara në prova dhe programet e bazuara në politikë, të cilat korrespondojnë me nevojat e qytetarëve. Në këtë rezultat bën pjesë edhe dialogu politik, në të cilin Ambasada e Zvicrës në Maqedoninë e Veriut do të ketë një rol aktiv me mbështetjen e organizatës e cila e zbaton Projektin.

Rezultati 3: Qytetarët e fuqizuar i thërrasin partitë politike dhe funksionarët e zgjedhur në përgjegjësi.

Aktivitete kryesore për Rezultatit 3: Qytetarëve do t'u ofrohen mundësi për rritjen e kapaciteteve të tyre në mënyrë që të dëgjohen interesat dhe kërkesat e tyre. Përmes rrjetit të ashtuquajtur "Mobilizatorë të bashkësisë"⁴, bashkësitë lokale do të kenë informata por edhe do të kenë mundësi të mësojnë për zgjedhjet, kandidatët dhe programet e tyre, do të ndërveprojnë me funksionarët publikë duke përdorur materiale të ndryshme informuese, takimet e këshillave komunalë, platforma të dedikuara për këto qëllime, mediat shoqërore etj. Projekti do të zhvillojë mekanizma për OSHQ-të⁵ ndërsa qytetarët do t'i mbikëqyrin premtimet zgjedhore të partive politike, si dhe realizimin e tyre.

Përfitues

Administrata zgjedhore në tri nivele, e cila përbëhet nga **KSHZ, 80 KKZ** dhe Komisioni Zgjedhor i Qytetit të Shkupit dhe përfaqëson rreth **3.500 KZ** do të jenë grupi i synuar që do përfshihet nga Projekti drejtpërdrejtë përmes trajnimit, edukimit dhe zbatimit të politikave. Përfitues të projektit do të jenë edhe partitë politike. Megjithatë, përfitues kryesorë janë votuesit, qytetarët e Maqedonisë së Veriut, veçanërisht të rinjtë, **gratë dhe grupet vulnerable**⁶ të cilët do përfitojnë

³Qendra Analitike-Hulumtuese

⁴Mobilizatorë në bashkësi janë aktivistët e organizatave qytetare, mediat, rinia ose qytetarët aktivë të bashkësisë të cilët do të zgjidhen përmes thirrjes së hapur. Ata do të bëjnë trajnime për t'i avancuar kapacitetet e tyre që në mënyrë plotësuese t'i zhvillojnë aftësitë e tyre për pjesëmarrjen publike, përfaqësimin/avokimin, monitorimin e platformave partiake dhe realizimin qeveritar, si dhe interaksionin me përfaqësuesit e zgjedhur.

⁵Organizatata qytetare (organizata të shoqërisë civile)

⁶Grupet vulnerable, në këtë Projekt, janë personat me nevoja të posaçme, popullsia rurale dhe/ose ajo që jeton në vise të



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



National Youth Council
of Macedonia



Global Expertise. Local Solutions.
Sustainable Democracy.



nga përfshirja më e madhe e proceseve politike dhe zgjedhore, dhe nga ndërgjegjësimi më i madh për nevojat, sfidat dhe pengesat me të cilat përballen në procesin zgjedhor.

Krahas administratës zgjedhore, projekti fokusohet edhe mbi disa palë të interesuara kryesore në procesin zgjedhor, me qëllim të përmirësimit të njohurive dhe kompetencave të tyre lidhur me procesin zgjedhor dhe praktikrat e mira ndërkombëtare. Këtu bëjnë pjesë:

- Institucionet qeveritare, siç janë Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës; Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audio Vizive; Enti Shtetëror i Statistikës; Avokati i Popullit; Enti Shtetëror i Auditimit; Ministria e Punëve të Brendshme; Ministria e Drejtësisë etj.
- partitë politike;
- organizata qytetare;
- votues dhe qytetarë.

Gjinia dhe administrimi: Projekti korrespondon me strategjitë dhe politikat⁷ nacionale të cilat kanë për qëllim të sigurojnë përfaqësimin e balancuar gjinor në të gjitha nivelet dhe në të gjitha aspektet e zbatimit. Projekti, mes tjerash, do të ofrojë mbështetje për rishikimin e procesit të kandidimit dhe do ta avancoj përfaqësimin e barabartë gjinor. Veç tjerash, do të ndihmojë në identifikimin dhe zgjidhjen e pengesave teknike të cilat e pamundësojnë pjesëmarrjen e grave në proceset politike dhe zgjedhore. OSHQ do të kenë mbështetje që t'i rrisin kapacitetet e tyre vëzhguese dhe përfaqësuese, me qëllim të barazisë më të madhe në shoqëri.

Duke i pasur parasysh raportet sensitive politike dhe ndëretnike në vend, Projekti do t'i mbështes protagonistët politikë dhe vendimmarrësit në përpjekjet e tyre për të arritur një kohezion më të madh ndëretnik dhe do të promovojë masa për përfshirjen më të mirë sociale të grupeve më vulnerable të qytetarëve.

Qëndrueshmëria: Ndërhyrja e propozuar ka për synim të krijoj politika të qëndrueshme, mekanizma dhe sisteme që do të kontribuojnë për njohuri, kapacitete dhe resurse më të mëdha të palëve të interesuara kryesore për përmirësimin e punës së tyre. “Produktet” e drejtpërdrejta të Projektit, si dhe resurset dhe aftësitë e përmirësuara, do të mbeten tek grupi i synuar. Përveç kësaj, ndryshimi i sjelljes dhe bindjeve do të sigurojë stabilitet dhe qëndrueshmëri të rezultateve të Projektit.

largëta

⁷Strategjia nacionale për barazi dhe mosdiskriminim, propozim Plani nacional i veprimit për barazi gjinore, Strategjia për bashkëpunimin e Qeverisë me shoqërinë civile, Strategjia nacionale për të rinjtë dhe Strategjia nacionale për barazimin e të drejtave të personave me nevoja të posaçme



Ndërhyrjet gjithashtu nënkuptojnë edhe krijimin e rrjetit të mobilizuesve brenda bashkësisë në mbarë vendin, të cilët do të kontribuojnë në qëndrueshmërinë e rezultateve. Njohuria dhe instrumentet e krijuar për nevojat e hulumtimeve të bazuara në prova dhe programet partiake të bazuara në politika, do të inkorporohen në IAC të partive politike. Vendosja formale e politikave, instrumenteve dhe sistemeve do të shqyrtohet më vonë me institucionet përkëstëse shtetërore dhe me universitetet për një gamë të gjerë të moduleve dhe materialeve arsimore që do të përdoren si materiale mësimore.

Periudha e zbatimit

Projekti për reforma zgjedhore do të zbatohet brenda periudhës kohore 10 vjeçare, duke filluar nga muaji korrik i vitit 2019 deri në qershor të vitit 2029.

Faza kryesore 1 do të zhvillohet brenda periudhës kohore **korrik 2019 - qershor 2023**. Aktivitetet e përshkruara më lartë kanë të bëjnë me këtë fazë.

Faza kryesore 2 planifikohet të zbatohet brenda periudhës kohore të viteve 2023-2027, pas të cilës do vijojë Faza e daljes, e cila do të zgjasë deri në vitin 2029.

Rreth IFES: I themeluar në vitin 1987, IFES është organizatë jopartiake që punon në përforcimin e politikave autentike dhe transparente dhe në proceset zgjedhore në vende anë e mbanë botës. Në Maqedoninë e Veriut, IFES bashkëpunon në mënyrë gjithëpërfshirëse me Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve që nga viti 2016, duke kontribuar në avancimin dhe konsolidimin e zbatimit të proceseve zgjedhore.

Rreth: I themeluar në vitin 2013, KNRM bashkon 48 organizata të cilat punojnë për mbrojtjen e të drejtat rinore në jetën publike, politike, kulturore dhe afariste. KNRM i përfaqëson të rinjtë pavarësisht statusit të tyre socio-ekonomik, gjinisë, racës, origjinës etnike/kulturore, bindjeve politike ose fetare, orientimit seksual, identitetit gjinor ose dallimeve tjera. Anëtarësia e shumëllojshme e KNRM bashkon organizata të cilat veprojnë në nivel evropian, nacional dhe lokal.



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



National Youth Council
of Macedonia



Global Expertise. Local Solutions.
Sustainable Democracy.